

KËRKIME GJUHËSORE

Fridrik DULAJ

DISA TIPARE TË SISTEMIT FOLJOR TË SË FOLMES SË RAHOVECIT ME RRETHINË

(Punimi është pjesë e studimit të doktoratës)

Ashtu si gjithandej në dialektet e shqipes, edhe në këtë të folme, *folja* është ndër pjesët më të rëndësishme të ligjëratës, e cila paraqet dallimet në mes dialekteve apo të folmeve, por megjithatë, duhet thënë se dallimet e sistemit foljor nuk janë të një karakteri të thellë strukturor. Shumë dallime morfologjike janë formuar duke pësuar ndryshime fonetike mbaresat vetore në një kategori foljesh¹. Sistemi foljor, ashtu siç e kanë theksuar edhe ata që janë marrë me gramatikën historike (E. Çabej, Sh. Demiraj² e I. Ajeti³), ka ruajtur elemente të vjetra të trashëgimisë indoevropiane. Mbasesat vetore paraqesin dallime të rëndësishme, të cilat duhet të studiohen me kujdes. Për sa i përket të folmes së Rahovecit me rrethinë, me gjithë dallimet që mund të na dalin gjatë trajtimit që do t'i bëjmë foljes, është rrugëtim i përbashkët me të folmet rreth saj, me të folmen e Gjakovës, të folmen e Prizrenit, të folmen e Deçanit, të folmen e Llapushes dhe të folmet e tjera verilindore⁴. Ndryshimet kryesisht do të jenë në krahasim me standardin si: në formimin e formave të pashtjelluara të foljes si: *me punu, me knu, me kcy me shkue, me marr, me pru, me vjel; tuj shkue, tuj ardhë, tuj fjetë, tuj u la;* etj. Tipologjia e mbasesave për formimin e së pakryerës: format me **-sh**, që është dhe një dallim i theksuar ndërmjet dy dialekteve të shqipes si: *punojsha, shkojsha, lajsha, vijsha; mblidhsha, derdhsha, pritsha* etj⁵.

E pakryera. Duke e ditur faktin se koha e pakryer paraqet një veprim i cili fillon në një çast të së shkuarës dhe ruan lidhshmëri me çastin e ligjërit⁶. Sa lidhet me të pakryerën në të folmet e shqipes, profesor Gj. Shkurtaj shfaq mendimin se "...foljet e grupit të parë (mënyra dëftore, koha e pakryer), nëpër të folmet e shqipes kanë një larmi të madhe formash të së pakryerës. Kjo larmi është krijuar prej rrugëve të ndryshme që ka ndjekur kjo formë gjatë zhvillimit të saj në treva të ndryshme të shqipes.

Në këtë larmi të madhe formash të së pakryerës dallohen dy areale kryesore: i pari, ai i gjithë toskërishtes, i të folmeve kalimtare dhe i një numri shumë të vogël të folmesh të gegërishtes, ku, me gjithë zhvillimet fonetike dhe gramatikore që kanë ndodhur, vërehet ruajtja e tipit më të hershëm dhe më të përbashkët të së pakryerës me **-nja** (*lanja*) ose me **-ja** (*laja*) dhe i dyti, areali që

¹ Shih: J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, *Dialektologjia shqiptare*. f. 221.

² Shih: Sh. Demiraj, *Gramatika historike*. Rilindja, Prishtinë 1988, f. 656-1004.

³ I. Ajeti, *Studime dialektore dhe etimologjike*, ASHSH, Tiranë 2005, f. 330-336.

⁴ Shih: H. Agani, *Fjalori i Lubomir Kujunxhiçit*, Prishtinë, 1981, f. 224.

⁵ Shih: Gj. Shkurtaj, *Shqipja e sotme*. Ufo Universty, Tiranë 2010, f. 156.

⁶ Shih: Grup autoresh, *Gramatika e gjuhës shqipe I*, ASHSH, Tiranë 2002, f. 274.

formon një tip tjetër të së pakryerës, tipin sigmatik me mbaresën **-sha (-jsha)** (*lasha / lajsha* “laja”).”⁷

Duke u mbështetur edhe në mendimin e profesor Gj. Shkurtajt, theksojmë se e pakryera e mënyrën dëftore në këtë të folme nuk paraqet ndonjë dallim në raport me të folmet e tjera në Kosovë.

Format e të pakryerës së dëftores paraqesin ndryshime në mes brezash në këtë të folme. Kështu të brezi i vjetër kohën e pakryer e dëftores e ndërton duke i prapavendosur mbetjen përemërore të formës së foljes -na, forma veprorë merr këto mbaresa: **(-j)shna, -(j)she, -(j)ke** dhe për numrin shumës: **-shum, -shit, -shin**, që në shqipen standarde dalin mbaresat: **-ja, -je, -te**, ndërsa në shumës: **-nim, -nit, -nin**.

E pakryera e foljeve të zgjedhimit të parë: **Un** *marojshna, lexojshna, këojshna, punojshna, kecejshna, shkruajshna, lyjshna, fshijshna, najshna*. / **Ti** *marojshje, lexojshje, këojshje, punojshje, kecejshje, shkruajshje, lyjshje, najshje*. / **Ai**, *ajo marojke, lexojke, këojke, punojke, kecejke, shkruajke, lyjke, najke*. / **Na** *marojshim, lexojshim, këojshim, punojshim, kecejshim, shkruajshim, lyjshim, najshim*. / **Ju** *marojshit, lexojshit, këojshit, punojshit, kecejshit, shkruajshit, lyjshit, najshit*. / **Ata, ato** *marojshin, lexojshin, këojshin, punojshin, kecejshin, shkruajshin, lyjshin, najshin*.

Në vetën e parë shumës, karshi mbaresës **-shim** për të pakryeren, dëgjohet edhe mbaresa **-shum** p.sh: *marojshum, lexojshum, këojshum, punojshum, kecejshum, shkruajshum, lyjshum, najshum*. Kjo dëgjohet kryesisht te brezi i vjetër.

Te foljet e zgjedhimit të dytë, të cilat dalin me bashkëtingëllore, mbaresat janë: **-sha, -she, -ke**, në numrin shumës: **-shim, -shit, -shin**, edhe në këtë pikë, në veten e parë të shumës kemi një përdorim të dy formave te brezi i vjetër zanorja e mbaresës **-shim** kthehet në **-u (-shum)**. Dallim në raport me të folmet e tjera paraqet përdorimi i foljeve që dalin me temë me zanoren **e**. Te brezi i vjetër këto folje dëgjohen që zanorja **e** të kthehet në **i**.

Shënim: Folja **punoj** dhe **laj** në të folmen e Rahovecit del me mbaresat e njëjta siç është dhënë në hartat 118.b/1, 118.b/2, 118.b/3, 118.b/4, 118.b/5, 118.b/6⁸ të ADGJSH.

Një pjesë e fjalëve të poshtëshënuara dëgjohen në të dy format me **i** dhe me **e**: **Un** *mirrsha (mersha), dilsha (delsha), milsha (mjelsha), nxirrsha (nxjerrsha), korrsha, mlidhsha (mbedhsha), mjellsha, kasitsha (kositsha), prashitsha, vadisssha, vilsha(vjelsha)*. / **Ti** *mirrshe (mershe), dilshe, milshe (mjelshe), nxirrshe (nxjerrshe), korrshe, mlidhshe (mledhshe), millshe (mjellshe), kositshe (kosotshe), prasitshe, vadisshe, vilshe (vjelshe)*. / **Ai, ajo** *mirrke (merrke), dilke (delke), milke (mjelke), nxirrken (nxjerrke), korrke, mlidhke (mledhke), millke (mjellke), kasitke (kositke), prashitke, vadiske, vilke (vjelke)*. / **Na** *mirrshim (merrshim) dilshim (delshim), milshim (mjelshim), nxirrshim (nxjerrshim), mlidhshim (mledhshim), millshim (mjellshim), kasitshim (kositshim), korrshim, vadisshim (vaditshim), vilshim (vjelshim)*. / **Ju** *mirrshit, (merrshit) dilshit delshit, milshit (mjallshit), nxirrshit (nxjerrshit), korrrshit, mlidhshit (mledhshit), millshit*

⁷ Shih: Gj. Shkurtaj, *vep. cit.* f. 160.

⁸ Shih: ADGJSH, *vep. cit.* f. 352-357.

DISA TIPARE TË SISTEMIT FOLJOR TË SË FOLMES SË RAHOVECIT ME
RRETHINË

(mjellshit), kasitshit (kasitshit), vadishit (vaditshit), vilshin (vjelshit). / **Ata, ato** mirrshin (merrshin), dilshin (delshin), milshin (mjelshin), nxirrshin (nxjerrshin), korrshin, mlidhshin (mledhin), millshin (mledhshin), kasitshin (kositshin), vadishin (vaditshin), vilshin (vjelshin).

Shënim: format e kohës së pakryer të dëftores të foljeve veprorë që u mbaron tema me bashkëtingëllore si *vishja*, që janë dhënë në hartat 118.a/1, 118.a/2, 118.a/3, 118.a/4, 118.a/5⁹ dhe 118.a/6, sa i përket zgjedhimit të këtij grupi foljesh, të dhënat e ADGJSH, janë në përputhshmëri të plotë me gjendjen e sotme që është në të folmen e Rahovecit me rrethinë, p.sh: vishna vishshe, veshshke, vishshim, vishshin,

Shënim: edhe sa i përket foljes *pij* në të pakryen e dëftores në formën veprorë të dhëna në hartat 118.c/1, 118.c/2, 118.c/3, 118.c/4, 118.c/5, 118.c/6,¹⁰ të gjitha të dhënat e hartave janë në përputhshmëri me gjendjen e sotme të së folmes së Rahovecit me rrethinë, këtu duhet të shtojmë se karshi formes së vetes së parë shumës të dhënë në hartat e ADGJSH *pijshim* dëgjohet edhe forma *pijshum*, zanorja e mbaresës **i** kalon në **u**.

E pakryera e formës pësore-vetvetore. Edhe në këtë të folme, ashtu si në mbarë gegërishten verilindore, duhet të theksojmë se diateza pësore-vetvetore bëhet duke ia vendosur pjesëzën u të pakryerës së dëftores në formën veprorë, shih për këtë të folmen e Deçanit¹¹ ose të Anadrinit¹². Edhe në këtë pikë e folmja e Rahovecit me rrethinë nuk paraqet ndonjë ndryshim të madh.

Ndryshimet duhet të shihen kryesisht mes brezave të folësve të kësaj zone. Për sa u përket mbaresave të së pakryerës, forma joveprorë në përjashtim të vetës së parë njëjës që duhet të theksojmë se bashkëtingëllorja hundore *n* dëgjohet shumë rrallë. Mbaresat e njëjësit janë: **sh/n/a**, **-she**, **-ke**, ndërsa në numrin shumës : **-shum**, **-shi**, **-shin**. Si p.sh: *u lash/n/a*, *u lysh/n/a* (por edhe *u lajsh/n/a*, *u lyjsh/n/a*), *ti u lashe*, *u lyshe* (*u lajshe*, *u lyjshe*), *ai, ajo u lahke*, *u lyhke* (*u lajke*, *u lyjke*), *na u lashum*, *lyshum*, (paralelisht me mbaresën **-shum**, dëgjohet edhe mbaresa **-shim** si: *u lajshim*, *u lyshim* etj.), *ju u lajshit*, *u lyshit*.

Un: *u lajshna* (*la^hshna*), *u lyjshna* (*ly^hshna*), **Ti** : *u lajshe*, *u lyjshe*, **Ai, ajo** : *u lajke*, *u lyjke*, **Ne** : *u lajshum*, *u lyjshim*, **Ju** : *u lajshit*, *u lyjshit*, **Ata, ato** : *u lajshin*, *u lyjshin*

Ashtu siç e thamë edhe më lartë, karshi këtyre formave shpesh dëgjohen edhe format : *un u lajsha* (*la^hsha*), *u lyejshe* (*ly^hsha*), që do të thotë se nuk dëgjohet bashkëtingëllorja hundore **n**. Këto forma dëgjohen kryesisht në arealin e Ratkocit. Mbaresat e vjetra të së pakryerës së diatezës pësore-vetvetore **esha**, **eshe**, **ej**, për shumësin: **eshim**, **eshit**, **eshin**, të cilat dëgjohen në të folmen e Peshterit¹³, apo edhe në të folmen e qytetit të Elbasanit me rrethinë¹⁴. Edhe në këtë

⁹ Shih: ADGJSH, *vep. cit.* f. 346-351.

¹⁰ Shih: ADGJSH, *vep. cit.* f. 358-363.

¹¹ Shih: B. Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, IAP Prishtinë, 2006. f. 91.

¹² Shih: N. Pajaziti, *E folmja e Anadrinit*, IAP, Prishtinë, 2008, f. 201.

¹³ Shih: L. Mulaku-M. Bardhi, *Mbi te folmen e shqipe të Peshterit*, "Studime Gjuhësore", Prishtinë 1978, f. 313.

¹⁴ Shih: Xh. Gostorani, *Struktura gramatikore e se folmes së qytetit të Elbasanit dhe leksiku i saj*, Dialektologjia shqiptare, VII, Tiranë 2005, f. 84.

të folme, ashtu si në shumë të folme të tjera verilindore dhe të folmet e Kosovës nuk dëgjohen si p.sh e folmja e Deçanit¹⁵. Në të folmen tonë dëgjohen mbaresat: **sha** për veten e parë njëjës, **she** për veten e dytë njëjës dhe **ke** për veten e tretë njëjës. Ndërsa për shumësin veta e parë merrë **shim**, veta e dytë **shit** dhe veta e tretë **shin**: **Un**: u lagsha, u merzitsha, u zhegitsha, u rritsha, u nxitsha, u nxirrsha, u sterpiksha, u zdjergsha. / **Ti**: u lagshe, u merzitshe, u zhegitshe, u rritshe, u nxitshë, u nxirrshe, u sterpikshe, u zdjergshe. / **Ai, ajo**: u lagke, u merzitke, u zhegitke, u rritke, u nxitke, u nxirrke, u sterpikë, u zdjergke. / **Na**: u lagshim, u merzitshim, u zhegitshim, u rritshim, u nxitshim, u nxirrshim, u sterpikshim, u zdjergshim. / **Ju**: u lagshit, u merzitshit, u zhegitshi, u rritshi, u nxitshi, u nxirrshi, u sterpikshi, u zdjergshi. / **Ata, ato**: u lagshin, u merzitshin, u zhegitshin, u rritshin, u nxitshin, u nxirrshin, u sterpikshin, u zdjergshin.

E kryera e thjeshtë. E kryera e thjeshtë paraqet një veprim i cili ka përfunduar në një çast të së shkuarës¹⁶. Andaj në këtë të folme paraqitet me disa ndryshime jo vetëm me të folmet e tjera verilindore, por dhe vet zona e Rahovecit. E folmja e Ratkocit dhe e arealit të Krushës nuk janë unike. Mbaretat për kohën e kryer të thjeshtë do t'i shohim sipas dy pikave të hetimit. Ratkocin me fshatrat rreth tij dhe Krusha e Madhe me fshatra rreth saj. Rahoveci në këtë pikë, ka të njëjtat mbaretat. Folja në kohën e kryer të thjeshtë në Ratkocin me rrethinë del me mbaretat vetore: a, e, i. Të gjitha foljet me temë me zanore në mes temës dhe mbaretës marrin bashkëtingëlloren antihiatizuese v në tri vetat e njëjësit, që del po thuajse në të gjitha të folmet e shqipe. Ndërsa në numrin shumë : m, t, n:

Un: punova, lexova, shkrova, shkeva, kënova, vrapova (java), bleva, leva (lyva), fshiva. / **Ti**: punove, lexove, shkrove, shkeve, kënova, vrapova (java), bleve, leve (lyve), fshive. / **Ai, ajo**: punoi, lexoi, shkroi, kënoi, vrapoi. / **Na**: punum, lexum, shkrum, shkym, këum, vrapum (jam), blem, lym, fshim. / **Ju**: punut, lexut, shkrut, shkyt, këum, vraput (ajti), bletet, lyjtet, fshijtë, / **Ata, ato**: punun, lexun, shkrun, shkyn, këun (jan), blen, lyn, fshin.

Në vetën e tretë njëjës disa folje nuk dalin me zanoren **i** por me zanoren **u**. p.sh: fshiu (fshivi), bleu (blevi), shkeu (shkevi).

Në arealin e Krushës, veçmas te brezi i vjetër dhe brezi i mesëm, e më pak apo shumë rrallë te brezi i ri dhe ai i shkolluar, në disa raste, e kryera e thjeshtë merr mbaretat **ta, te, ti**, (kjo e fundit e trajtuar edhe më lart) dhe shumësit **tem, tet, ten**, në vend të mbaretave **-va, -ve, -i**, ose të shumësit **-m, -et, -an**. Duke ia prapavendosur mbaretat e formës foljore të kohës së tashme: **Un**: shkoj-**ta**, punoj-**ta**, lexoj-**ta**, ndërtoj-**ta**, mbaroj-**ta**, kërkoj-**ta**, filloj-**ta**, vrapoj-**ta**, mbuloj-**ta** etj., / **Ti**: shkoj-**te**, punoj-**te**, lexoj-**te**, ndërtoj-**te**, mbaroj-**te**, , mbuloj-**te**, vrapoj-**ta**, / **Ai**: shkoj-**ti**, punoj-**ti**, lexoj-**ti**, ndërtoj-**ti**, mbaroj-**ti**, kërkoj-**ti**, mbuloj-**ti**, vrapoj-**ti**. / **Na**: Un: shkoj- tum, punoj- tum, lexoj- tum, ndërtoj- tum, mbaroj- tum, kërkoj- tum, filloj- tum, vrapoj- tum, mbuloj- tum etj., / **Ju**: Un: shkoj- tet, punoj- tet, lexoj- tet, ndërtoj- tet, mbaroj- tet, kërkoj- tet, filloj- tet, vrapoj- tet, mbuloj- tet

¹⁵ Shih: B. Mehmetaj, vep. cit. f. 91.

¹⁶ Shih: G. Autorësh, Gramatika e gjuhës shqipe I, ASHSH, Tiranë 2002, f. 274.

DISA TIPARE TË SISTEMIT FOLJOR TË SË FOLMES SË RAHOVECIT ME
RRETHINË

etj., / **Ata, ato:** *Un: shkoj- ten, punoj- ten, lexoj- ten, ndërtoj- ten, mbaroj- ten, kërkuj- ten, filloj- ten, vrapoj- ten, mbuloj- ten* etj.,

/Shkojta pak para sabahit/.

/Eh! Punojte shuum baba jem shuum/.

/Mas pari e marojti ni kalib sa me shti kryjen mreña/.

/shkojti deri te dera s`hini mreña/

Shënim: Folja *shtyj*, në të kryerën e thjeshtë e paraqitur në hartën numër 120¹⁷ të ADGJSH, në të folmen e Rahovecit me rrethinë del në dy forma: **un:** *shtyna, shtyva*, **ti:** *shtyne, shtyjt*, **ai:** *shtyjt, shtyni*, **na:** *shtynem, shtyjtem*, **ju:** *shtynet, shtytem*, **ata:** *shtyten, shtytjen*. Folja *shava, ndaj, paguaj*, të dhëna në hartën numër 121¹⁸ të ADGJSH, ashtu siç është dhënë për pikën 35 edhe në këtë të folme dalin me po ato mbaresa¹⁹ *shava, shajta, dava, dajta, paguva, pagujta, preva, prejta*.

Ndërsa në fshatrat që i përfshin areali Ratkocit nuk dëgjohej një zgjedhim i tillë. Në këtë rajon madje është vështirë të dallohet veta e tretë e njëjës të së kryerës së thjeshtë nga veta e parë e njëjës të së tashmes, kur dihet se bashkëtingëllorja **j** është pothuajse e ngjashme me zanoren e ngritjes së lartë **i**²⁰. Psh: *shkoj* (shkoi), *lexoj* (lexoi), *punoj* (punoi); / Une punoj sa tre vet. (koha e tashme). / *Ai punoj tan ditën*. (koha e kryer e thjeshtë).

Në numrin shumës të së kryerës së thjeshtë, ashtu si në shqipen standarde edhe kjo e folme zanoren **o** të temës e kthen në diftongun **ue** (shqipja standarde **ua**), por e redukton atë menjëherë në zanoren e parë **u**, duke paraqitur këto mbaresa shku-**tem**, **tet**, **ten**. Psh: *Po bre shkutem von, por edhe shkum*. / *Ju bajtet shum dru*.

Këtu duhen përjashtuar foljet **laj** dhe **pi**, të cilat dëgjohej njëllor në të dy arealet e kësaj zone²¹, në përjashtim të vetës së tretë të numrit njëjës të kohës së kryer të thjeshtë, që përveç bashkëtingëllores **v** ka dhe zanoren **i**: *pivi, lavi, vravi*, të cilat dëgjohej në arealin e Krushës etj.: *Pivi pa masë, e tashi le t`rri rat*. / *Lavi teshet dhe shkojti meniher...*

Ndërsa në fshatrat Ratkoc, Malësi e Vogël, Dejë, Dobidol, Çifllak, Kramovik, Palluzhë, Drenoc, Pataçan i Ulët etj., nuk dëgjohej zanorja **i**, si në shembujt e më lartë, as trajta letrare e diftongut **au**. Në këtë pjesë të fshatrave foljet e lartshënuara kanë këto mbaresa vetore: **ta, te, -v/-i/**, dhe për shumës **tem, tet, ten**.

Un *pijta* (pi-va) *pitem* (pimë)

I *lajta* (la-va) *lajtem*

Ti *pite* (pi-ve) *pitet* (pitë)

II *lajte* (la-ve) *lajtet*

Ai *piti*, (pi-u) *piten* (pijen)

III *lajti*, *lavi* (lau) *lajten*

¹⁷ Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 369.

¹⁸ Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 370.

¹⁹ Shih: Gj. Shkurtaç, vep. cit. f. 164.

²⁰ Shih: Zijadin Munishi, *Gjuha shqipe dhe kultura e të shprehurit*, ETMM, Prishtinë 1984, f. 41.

²¹ Shih hartën.

Foljet e zgjedhimit të dytë, si në shumë të folme të shqipes, edhe në këtë të folme dalin me mbaresat: **a, e, i**, po tash jo si te foljet e zgjedhimit të parë me bashkëtingëlloren antihiatizuese **-v-**. Ndërsa në shumës: **em, et, en**.

Un: *mata, hypa, hapa, ika, çela, sosa, prita, mledha, dredha, vjela, morra.* / **Ti:** *mate, hype, hape, ike, çele, sose, prite, mledhe, dredhe, vjele, morre.* / **Ai, ajo:** *mati, hypi, hapi, iki, çeli, sosi, priti, mledhi, dredhi, vjeli, morri.* / **Na:** *matem, hypem, hapem, ikem, çelem, sosem, pritem, mledhem, dredhem, vjelem, morrem.* / **Ju:** *matet, hypet, hapet, iket, çelet, soset, pritet, mledhet, dredhet, vjelet, morret.* / **Ata, ato:** *maten, hypen, hapen, iken, çelen, sosen, priten, mledhen, dredhen, vjelen, moren.*

Për dallim nga dy arealet tjera të folmes sonë, në arealin e Krushës kemi një grup foljesh që të kryerën e thjeshtë e bëjnë me anë të ndërrimit të zanores së temës: **Un:** *dula, vula,* / **Ti:** *dule, vole (por edhe vule)* / **Ai, ajo:** *duli, voli (edhe vuli)* / **Na:** *dulem, volem (edhe vulem)* / **Ju:** *dulet, volet (edhe vulet)* / **Ata, ato:** *dulen, volen (edhe vulen).*

E kryera e dytë (e mbipërbëra). E kryera e dytë në të folmen e Rahovecit me rrethinë gjen përdorim të gjerë. Këtë dukuri të ndërtimit të formave të mbipërbëra në gjuhën shqipe Ethem Likaj e trajton gjerë e gjatë në librin e tij “Format analitike në gjuhën shqipe” ndër të tjera ai thotë “...Veç formave analitike të së kryerës, më se të kryerës dhe së kryerës së tejshkuar në gjuhën shqipe ndeshen edhe disa forma të tjera analitike të quajtura “të mbipërbëra”: ka pasë thanë, kish pas ra. Kryesisht këto forma gjenden në të folmet popullore të Shqipërisë Veriore... këto kohë të mbipërbëra janë krijuar mbi bazën e raporteve të reja që lindin në kushtet e gramatikatzimit të plotë të formave analitike të ndërtuara me folje ndihmëse. Janë raporte të reja kohore të shprehura vërtet nga kundërvënja e formave të plota **kam punuar** – *kam pas punuar*, por të ndërtuara nëpërmjet kundërvënies së mjeteve gramatikore *kam-kam pas*, çka duket qartë në humbjen e të gjitha ngjyimeve të tjera, veç atyre kohore”²². Edhe profesor Gj. Shkurtaj, në librin e tij e thekson si një dallim ndërmjet dialekteve të shqipes duke u shprehur se “dialektet e shqipes dallohen qartë në praninë e formave të mbipërbëra të së shkuarës (tipi: *kam pas dalë*)”²³.

Edhe në këtë punim këtë kohë foljore do ta quajmë të mbipërbëra, ngase ajo ndërtohet nga përdorimi i dy foljeve ndihmëse. Folja ndihmëse **kam** në diatezën veprorë dhe folja ndihmëse **jam** përfaqësues e diatezës pësorë-vetvetore. Kjo kohë foljore në të folmen e Rahovecit me rrethinë gjen përdorim të dendur, ngase format e mbipërbëra të foljes në këtë të folme duket të jenë në përdorim së paku që nga fillimi i shekullit të kaluar. Një dukuri e tillë i kishte ndihmuar edhe H. Aganit në përcaktimin e trevës gjuhësore të Fjalorit të L. Kujunxhiçit²⁴.

Un: *kam pas shku, kam pas lexu, kam pas kcy, kam pas maru, kam pas ñejt, kam pasmledh, kam pas mjell, kam pas mjel.* / **Ti:** *: ki pas shku, ki pas lexu, ki*

²²Shih: E. Likaj, *Format analitike në gjuhën shqipe*, SHBLU, Tiranë 2000, f. 55-56.

²³ Shih: Gj. Shkurtaj, *vep. cit.* f. 165.

²⁴ Shih: H. Agani, *vep. cit.* f. 275-276.

DISA TIPARE TË SISTEMIT FOLJOR TË SË FOLMES SË RAHOVECIT ME
RRETHINË

pas kcy, ki pas maru, ki pas ñejt, ki pasmledh, ki pas mjell, ki pas mjel. / Ai, ajo: ka pas shku, ka pas lexu, ka pas kcy, ka pas maru, ka pas ñejt, ka pas mledh, ka pas mjell, ka pas mjel. / Na: kemi pas shku, kemi pas lexu, kemi pas kcy, kemi pas maru, kemi pas ñejt, kemi pas mledh, kemi pas mjell, kemi pas mjel. / Ju: kini pas shku, kini pas lexu, kini pas kcy, kini pas maru, kini pas ñejt, kini pas mledh, kini pas mjell, kini pas mjel. / Ata, ajo: kân pas shku, kân pas lexu, kini pas kcy, kân pas maru, kân pas ñejt, kân pas mledh, kân pas mjell, kân pas mjel.

Duhet të theksojmë këtu se paralelisht me formën foljore të ndihmëses *kam* në veten e parë shumë kemi, jo rrallë herë, e kryesisht te brezi i vjetër dëgjohet forma foljore: *kena pas shku, kena pas kcy, kena pas maru, kena pas luftue, kena pas mledh, kena pas mjell, kena pas mjel.*

Shënim: Paradigma e së kryerës së vetës dytë që është paraqitur në hartën 123²⁵ të ADGJSH *kam pasë dalë*, siç është dhënë në shpjegimin më lartë dhe në përputhje të plotë me të dhënat e ADGJSH, në të folmen e Rahovecit me rrethinë dëgjohet, si p.sh: *ka pas shku, ka pas lexu, ka pas kcy, ka pas maru, ka pas ñejt, ka pas mledh.*

Diateza pësore-vetvetore Un: *jam kân lodh, jam kân merzit, jam kân trullu, jam kân martu, jam kân gzu, jam kân idhnu. / Ti: ji kân lodh, ji kân merzit, ji kân trullu, ji kân martu, ji kân gzu, ji kân idhnu. / Ai, ajo: â kân lodh, â kân merzit, â kân trullu, â kân martu, âkân gzu, â kân idhnu. / Na: jimi kân lodh, jimi kân merzit, jimi kân trullu, jimi kân martu, jimi kân gzu, jimi kân idhnu. / Ju: jini kân lodh, jini kân merzit, jini kân trullu, jini kân martu, jini kân gzu, jini kân idhnu. / Ata, ato: jan kân lodh, jan kân merzit, jan kân trullu, jan kân martu, jan kân gzu, jan kân idhnu.*

Edhe këtu po theksojmë se folja ndihmëse *kam* në funksion të ndërtimit të kohës së mbipërbërë për formën e diatezës pësore vetvetore dëgjohet /kâ:/ e prirë gjithnjë nga folja ndihmëse *jam*. P.sh: **un:** *jom kâ: livrij, jom kâ: laj tesh, jom kâ: maroj; ti:* *je kâ: livron, je kâ:lan tesh, je kâ: maron; ai, ajo:* *â kâ: livron, â kâ:lan tesh, â kâ: maron; na:* *jem kâ: livrojm, jem kâ: lani tesh, jem kâ: marojm; ju:* *jini kâ: livroi, jini kâ: lani tesh, jini kâ: maroni; ata, ato:* *jan kâ: livrojn, jan kâ: lajn tesh, jan kâ: marojn.*

Më se e kryera e dytë (e mbipërbërë). Edhe koha e mbipërbër e kohës së më se të kryer në këtë të folme dëgjohet mjaft shpesh. Ajo ndërtohet duke ia paravendosur pjesores së foljes formën e pakryer të foljes ndihmëse **kam** dhe pas saj pjesoren e ndihmëses **kam** pas për formën veprorë. Ndërsa i paravendoset folja ndihmëse **jam** në të pakryerën (isha) dhe foljen ndihmëse **kam**, plus pjesorja, në të tashmen për diatezën pësore-vetvetore. p.sh., **Un:** *kisha pas harrru, kisha pas hañer, kisha pas livru, kisha pas kñu, kisha pas kcy, kisha pas kallxu, kisha pas punu. / Ti: kishë pas harrru, kishë pas hañer, kishë pas livru, kishë pas kñu, kishë pas kcy, kishë pas kallxu, kishë pas punu. / Ai, ajo: kish pas harrru, kish pas hañer, kish pas livru, kish pas kñu, kish pas kcy, kish pas kallxu, kish pas punu. / Na: kishum pas harrru, kishum pas hañer, kishum pas livru, kishum pas kñu, kishum*

²⁵ Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 372.

pas kcy, kishum pas kallxu, kishum pas punu. / Ju: kishit pas harru, kishit pas hañer, kishit pas livru, kishit pas kñu, kishit pas kcy, kishit pas kallxu, kishit pas punu. / Ata, ato: kishin pas harru, kishin pas hañer, kishin pas livru, kishin pas kñu, kishin pas kcy, kishin pas kallxu, kishin pas punu.

Shënim: Paradigma e së kryerës së plotë të dytë, e paraqitur në hartën 124²⁶ të ADGJSH, **kisha pas dal**, në këtë të folme siç edhe e kemi sqaruar me shembujt dhe zgjedhimet më lartë, përputhet plotësisht me të dhënat e ADGJSH, si p.sh: *kisha pas harru, kisha pas hañer, kisha pas livru, kisha pas kñu.*

Format e pashtjelluara të foljes. Format e pashtjelluara të foljes paraqesin një dallim tjetër në mes dialekteve të shqipes²⁷. Ashtu si edhe në të folmet tjera të gegërishtes, edhe në këtë të folme, format e pashtjelluara të gegërishtes dëgjohen dhe mbeten të pastandardizuara, me përjashtim pjesërisht të shtresa e brezit të ri, kryesisht të shkolluar. Format e pashtjelluara kanë tërhequr vëmendjen e shumë albanologëve shqiptarë dhe të huaj C. Taglavini, E. Çabej, Sh. Demiraj, J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, E. Likaj, B. Bokshi, R. Ismajli etj.

Pjesorja. Edhe në të folmen e Rahovecit me rrethinë pjesorja del pa mbaresa. Foljet, që mbarojnë me diftongun **ue**, në këtë të folme, diftongun e kanë monoftonguar në zanoren e parë **u**. Këtu duhet të veçojmë brezin e vjetër, i cili e ruan edhe më tutje diftongun **ue**. Kjo dëgjohet më shumë te fshatrat: Vrajkë, Bratatin, Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm, Nashpallë, Sopniq²⁸ p.sh: *punu:, vlu:, maru:, lexu:, msu:, me shku:, kñu:, ly:, kry:, kcy:, shty:, thy:, fry:, fshi: etj.*

Këto forma të pjesores kur kalojnë në mbiemra marrin njëen e përparme -i, mbaresën -m ose kur marrin njëen -e marrin mbaresën -em, p.sh: *i punum, i vlum, i marum, i lexum, i msum, i kñum, i lym, i krym, i kcy, i shtym, i thym, i frym, i fshim etj.*, ndërsa kur marrin njëen -e p.sh: *e punume, e vlume:, e marume, e lexume, e msue, e kñume, e lyme, e kryme, e kcy, e shtyme, e thyme, e fryme, e fshme etj.*

Foljet që përfundojnë me bashkëtingëllore në formën e pjesores nuk kanë mbaresa, ndërsa zanoren e temës e kthen në zanore të gjatë²⁹ p.sh: *pje:k, dje:g, vje:l, da:l, kpu:t, ly:p, fa:l, mby:l, ko:rr, mje:ll, mje:l, ma:rr, dje:g, li:dh, çit:, dhe:z, kosi:t, pri:t, etj.*

Si në mbarë të folmet geqe, sidomos në të folmet verilindore, edhe në këtë të folme, që po e shqyrtojmë, ndërtohen mbiemra prejpjesorë, të cilët kur dalin me temë me bashkëtingëllore marrin mbaresën **-en** e në disa raste më të rralla dëgjohen edhe me mbaresën **-un**³⁰ si p.sh: *i pjeken, i djegen, i vjelen, i kputen, i dalen, i lypen, i falen, i mbyllen, i korren, i mjellen, i mjelen, i marren, i djegen, i lidhen, i çiten, i dhezen, i kositen, priten.*

Ndërsa të njëjtat forma mbiemërore prejpjesore kur përdorën në funksion të mbiemrave në gjininë femërore bashkëtingëlloresha hundore **-n-** do ti prijë

²⁶Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 373.

²⁷Shih: B. Beci, *Historia e formimit të dialekteve të shqipes*, "Dituria", Tiranë 2002, f. 22.

²⁸ *punue, vlu:, marue, lexue, msue, kñue, lye, krye, kcy, shtye, thye, frye, fshie.*

²⁹Shih: N. Pajaziti, vep. cit. f. 216. Po ashtu edhe B. Mehmetaj, vep. cit. f. 105.

³⁰Shih: Gj. Shkurtaj, vep. cit. f. 174.

DISA TIPARE TË SISTEMIT FOLJOR TË SË FOLMES SË RAHOVECIT ME RRETHINË

zanores –e- d.m.th -ne: e pjekne, e djegne, e vjelene, e kputne, e dalne, e lypne, e falne, e mbyllne, e korrne, e mjellne, e mjelne, e marrne, e djegne, e lidhne, e çitne, e dhezne, e kositne, e pritne.

Shënim: Forma e pjesores së foljeve veshur, *goditur, shitur*, siç është dhënë edhe në hartën 129.a.³¹, të ADGJSH edhe në këtë të folme dalin me mbaresën –un, *veshun, shitun* etj. Edhe forma e foljeve *them, jap, vë, lë, zë*, të paraqitura në hartën 129.b.³² të ADGJSH, gjendja e pjesores së këtyre foljeve është në përputhshmëri me të dhënat e ADGJSH, si p.sh: *thân, ja, lâ, zâ*.

Paskajorja. Ashtu si në mbarë dialektin e gegërishtes, edhe në këtë të folme ndërtohet me anë të pjesëzës **me** dhe formës së pjesores së foljes përkatëse³³. P.sh. : *me punu, me lexu, me shkru, me kënnu, me lidh, me maru, me lajt*.

Siç shihet edhe nga shembujt në këtë të folme ashtu si në shumë të folme të tjera verilindore forma e pashtjelluar është reduktuar. Por këtu, duhet përjashtuar fshatin Ratkoc, Vrajakë, Bratatin, sidomos në Pataqan i Ulët, Pataqan i Epërm, Nashpallë e Sopniq, që paraqesin dallim te brezi i vjetër, që e ka ruajtur formën e pareduktuar të gegërishtes psh : *me punue, me lexue, me shkruue, me këndue, me marue*.

Edhe në këtë të folme si në të folmet e tjera verilindore, p.sh si edhe në të folmet e tjera të gegërishtes verilindore, ndërtohen forma të paskajores me anë të pjesëzës mohuese **pa** : *pa la:, pa di :t, pa kpu:t, pa fje:t, pa da:l, pa majt, pa maru, pa kënu, pa lexu, pa msu pa punu, pa livru, pa lidh, pa vjel, pa korr, etj*.

Shpeshherë dëgjohet edhe forma e paskajores e ndërtuar me ndihmësen **kam** e duke e vendosur atë në mes pjesores dhe pjesëzës *me*, si psh: *me pa fol, , me pa, me pa lidh, me pa kesh, me pa kcy, me pa rreh, me ra, me la, me pa dek, me pa mill, me pa korr, me pa livru, me ardh etj*.

Edhe në këtë të folme dëgjohen format të paskajores, të cilat ndërtohen duke ia paravendosur pjesëzën –**per** formës së paskajores **me punu**³⁴ p.sh: *per me punu, per me maru, per me kcy, per me lexu, per me msu, per me mjell, per me vjel, per me mljel, per me mledh, per me korr, per me pjek etj*. Kjo formë e paskajores është kryesisht në funksion të rrethanorit të qëllimit, p.sh: *ka shku per me punu, ka nis per me maru, i ka math per me kcy, e ka marr per me lexu, ia ka nis per me msu, e ka livru per me mjell, per me vjel rrushin duhet argat, per me mjel duhet m'i pas brrylet e fort, per me mledh duhen garabujet, e kemi ble kumpajen per me korr, per me pjek buken duhet prushi etj*.

Në të folmen e Rahovecit dëgjohet edhe një formë tjetër e paskajores që ndërtohet me paravendosjen e pjesores së foljes trajta të shkurtëra të përemrit vetor: *m'u la, m'u shperla, m'u ly, m'u nxhy, m'u gzu, m'u idhnu, etj*.
/nuk a mir m'u la n'pru/, /nuk i ka hie m'u nxhy si nuse/

³¹Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 386.

³²Shih: ADGJSH, vep. cit. f. 387.

³³Shih: Gj. Shkurtaj, vep.cit. f. 175.

³⁴Shih: Gj. Shkurtaj, vep. cit. f. 175.

Përcjellorja. Përcjellorja nuk paraqet ndonjë ndryshim në raport me të folmet e tjera verilindore. Edhe në të folmen tonë përcjellorja ndërtohet duke ia paravendosur pjesores së foljes kryesore pjesëzën **tuj** dhe **tu**,³⁵ si edhe forma e përcjellores e ndërtuar me pjesëzën **kah** dhe **ka**. Të dy format janë të barazvlerfshme me formën e toskërishtes **duke**. Pjesëza **tuj** në rastin e dytë e bjerrë **j**-në, kurse forma **kah** në rastin e dytë **kah** e bjerrë **h**-në.

Shënim: Në të folmen e Rahovecit me rrethinë, paralelisht pjesëzës **tu** dëgjohet edhe pjesëza **tuj** të dhënë në hartën 128³⁶, të ADGJSH edhe në këtë pikë janë në përputhshmëri të plotë me situatën gjuhësore në terren. *tuj lexu, tuj msu, tuj shkru, tuj këu, tuj maru, tuj punu, tuj shkru, tuj mjell, tuj kcy, tuj pa, tuj dek, tuj ra, tuj la, tuj ardh, tuj korr, tuj korr, tuj lidh, tuj shku etj.*, të njëjtat fjalë dalin edhe me pjesëzën: *tu lexu, tu msu, tu shkru, tu këu, tu maru, tu punu, tu shkru, tu mjell, tu kcy, tu pa, tu dek, tu ra, tu la, tu ardh, tu korr, tu korr, tu lidh, tu shku etj.* Edhe forma tjetër është dëgjohet në dy mënyra: **kah** dhe **ka** p.sh: *kah lexoj, kah msoj, kah shkruj, kah këoj, kah maroj, kah punoj, kah shkruj, kah mjell, kah kcej, kah des, kah laj, kah vij, kah lidh etj.* Dhe rastet e rënies së grykores **h**: *ka shkruj, ka këoj, ka maroj, ka punoj, ka shkruj, ka mjell, ka kcej, ka des, ka laj, ka vij, ka lidh.*

Trajtat foljore: *vesi, flasi, shohi, marri, çesi*: Trajtat e këtyre foljeve, në vetën e parë të numrit njëjës, i kishte dëgjuar edhe prof. Agani gjatë punës së tij studimore³⁷ dhe format e tilla dëgjohen edhe sot te brezi i vjetër dhe ai i mesëm e shumë më rrallë te brezi i ri në fshatrat e arealit gjuhësor të Krushës. Përkatësisht në fshatrat: Apterushë, Zaçisht, Retijë, Brestoc, Hoçë e Vogël, Nagac, Krushë e Madhe si dhe fshatrat e komunës së Therandës dhe të Prizrenit që janë në kufij me këto fshatrat. P.sh. : **Vesi** *une niher masanejna t`kallxoj.* / **Flasi** *une me to.* / **Shohi** *çka po thotë aj.* / *Nuk po çesi ato detyrrat e fshtira/* (në Rahovec).

Hilmi Agani mendonte se kjo mbaresë kishte ardhur si rrjedhojë e nevojës së diferencimit të vetës së parë nga veta e dytë njëjës te foljet e kësaj kategorie (*vesi, flasi, shohi, çesi, marri etj.*) Me anë të këtyre trajtave edhe sot, ashtu si në kohën kur profesor Agani i kishte dëgjuar te dy brezat e parë e pak tek brezi ri, i cili i ka rralluar shumë këto trajta, mbi bazën e këtyre foljeve (*vesi, flasi, shohi etj.*), ndërtohet trajta e kuptimit të së ardhmes³⁸: *do t`vesi, do t`flasi, do t`marri, do t`çesi. Mos u merzit do t`flasi une me doktorrin. Do t`vesi maspari ktu e masnejna shkojm n`Prishtin.*

³⁵ Shih: Gj. Shkurtaç, *vep. cit.* f. 177.

³⁶ Shih: ADGJSH, *vep. cit.* f. 385.

³⁷ Shih: H. Agani, *vep. cit.* f. 266.

³⁸ Shih: H. Agani, *vep. cit.* f. 274.